



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 11525 Prot

Shkodër, më 18.5.2026

URDHËR
Nr. 571 Dt. 18/5 /2026

**MARRJE MASASH PËR RUAJTEN E QETËSISË SË PUSHUESVE NGA ZHURMAT NË
KANTIERET E NDËRTIMIT NË ZONËN E BREGDETIT TË VELIPOJËS DHE RRJOLLIT DHE
ATO TURISTIKE SHIROKË, THETH**

Bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” pika 4, pika 9, pika 14, në ligjin nr 93/2015 “Për Turizmin” i ndryshuar, Ligji nr. 9780 dt 16.07.2007 i ndryshuar, Ligjin 107/2014 neni 51 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” i ndryshuar me ligjin 119/2020, VKM nr 408 dt 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, VKM nr 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore

URDHËROJ:

- 1-Ndalimi i punimeve dhe kantiereve te jashtme gjatë sezonit 15 qershor deri në 15 shtator 2026
- 2-Ndalimin e kamionave të tonazhit të rëndë me materiale ndërtimi që kalojnë nëpër rrugët që frekuentohen nga pushuesit gjatë sezonit turistik 2026.
- 3-Ndalimi i punimeve me mjete si ekskavator, vinça, betoniere, matrapik në zonën e frekuentuar nga pushuesit për gjatë sezonit turistik.
- 4-Lejohen të bëhen në këtë periudhë vetëm punime të brendshme në ato kantiere që janë të mbyllura nga jashtë, duke mirëmbajtur rrugët që shpjen në kantier me ujë për të fashitur pluhurin.

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen:

- 1.Drejtoria e Administrimit dhe Menazhimit ZIN dhe TIK për publikimin e këtij urdhri
- 2.Njësia Administrative Velipojë, Njësia Administrative Shalë, Lagja nr 1 për njoftimin dhe sensibilizimin e qytetarëve
- 3.Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Shkodër së bashku me Policinë Bashkiake për monitorimin dhe kontrollin e zbatueshmërisë së këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!



**KRYETAR
BENET BECI**